

# Lista e marrëveshjeve dypalëshe

## Shqipëri-Austri

1. Marrëveshje ndërmjet Ministrit Federal të Tregtisë, Industrisë dhe Tregtisë së Republikës së Austrisë dhe Ministrit të Tregtisë të Republikës Popullore të Shqipërisë për transportin ndërkombëtar të mallrave me kamion. Nënshkruar më 23/07/1973, ka filluar zbatimin më 10/01/1973.
2. Ndryshimi i notave mbi bashkëpunimin kulturor dhe shkencor. Nënshkruar më 04/08/1987, ka filluar zbatimin në 04/08/1987.
3. Marrëveshje miqësore midis Qeverisë së Republikës së Austrisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi ndihmën ushqimore. Nënshkruar më 03/10/1991, ka filluar zbatimin në 03/10/1991.
4. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale Austriake mbi heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit. Nënshkruar më 26.06.1992, ka filluar zbatimin në 01/09/1992.
5. Marrëveshje kuadër mbi bashkëpunimin ndërmjet Ushtrisë Shqipëtare dhe Ushtrisë Federale Austriake, nënshkruar më 8.03.1993.
6. Marrëveshje midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, nënshkruar më 18.03.1993, hyrë në fuqi më 8.01.1995.
7. Marrëveshja e Shërbimeve Ajrore midis Qeverisë Federale Austriake dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë Shtojcën , nënshkruar më 18.03.1993, hyrë në fuqi 01/05/1994.
8. Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Ndërtimit të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale të Austrisë, nënshkruar më 20.10.1993.
9. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Austrisë mbi marrëdhëniet ekonomike dy palëshe, nënshkruar më 29.03.1994, hyrë në fuqi më 03/01/1996.
10. Protokoll i shkëmbimit të instrumentave të ratifikimit të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Austrisë për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, nënshkruar më 02.05.1995.
11. Procesverbalet në mes të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit Austriak dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivit Shtetëror Shqiptar në lidhje me bashkëpunimin në fushën e arkivave. Nënshkruar më 12/01/1998, hyrë në fuqi 12/01/1998.
12. Marrëveshje grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Qeverisë së Austrisë përfaqësuar nga Agjensia Austriake e Zhvillimit për financimin e projektit, Zhvillimi rural i integruar i zonës së Kelmendit, veriu i Shqipërisë, nënshkruar më 20.12.2004.
13. Protokoll i Sesionit të Tretë të Komisionit të Përbashkët shqiptaro- austriak për Bashkëpunimin Ekonomik, nënshkruar më 12.04.2005, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
14. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për bashkëpunimin në fushat e kulturës, arsimit dhe shkencës, nënshkruar më 31.10.2005, hyrë në fuqi më 1.11.2006.
15. Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe krahina e ulët (The Province of Loëer) e Austrisë dhe EVN AG, nënshkruar më 15.01.2007.
16. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për bashkëpunim dhe ndihmën në fushën e doganave, nënshkruar më 09.03.2007, hyrë në fuqi më 1.10.2007.
17. Marrëveshje grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe

- Qeverisë së Republikës së Austrisë për programin e barazisë gjinore, efektet e Marrëveshjes fillojnë nga data 17.09.2007.
18. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale Austriake për bashkëpunimit policor, nënshkruar më 29.06.2007, hyrë në fuqi më 1.02.2008.
  19. Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për shmangien e taksimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal, nënshkruar më 14.12.2007, hyrë në fuqi më 14.12.2007, fillon veprimi nga data 1.09.2008.
  20. Protokoll i takimit të komisionit të përzier austriako-shqiptar për bashkëpunimin në fushat e kulturës, arsimit dhe shkencës për vitet 2007 – 2010, nënshkruar më 28 qershor 2007.
  21. Protokoll i zbatimit të Marrëveshjes së ripranimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Austrisë, nënshkruar më 29.06.2007, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
  22. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për bashkëpunimin në fushat e kulturës, arsimit dhe shkencës, nënshkruar më 31.10.2005, hyrë në fuqi më 1.11.2006.
  23. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë mbi bashkëpunimin për zhvillim, nënshkruar, më 3.06.2008, hyrë në fuqi më 1.11.2008.
  24. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Austrisë mbi realizimin e sistemit të kompjuterizuar të Regjistrimit Kombëtar civil në Shqipëri, nënshkruar më 25.06.2008, hyrë në fuqi më 25.6.2008.
  25. Protokoll i Shtesë mbi marrëveshjen për zbatimin e sistemit kompjuterik për Regjistrimin Kombëtar Civil të Shqipërisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, nënshkruar më 4.12.2008, hyrë në fuqi më 4.12.2008.
  26. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeveria e Republikës së Austrisë përfaqësuar nga Ministri Federal i Financës mbi bashkëpunimin financiar, nënshkruar më 3.06.2008, hyrë në fuqi më 1.11.2008.
  27. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit (ADA) mbi asistencën grant financiare për Projektin e Furnizimit me ujë dhe mbrojtjen e liqenit të Shkodrës, nënshkruar më 19.12.2007 për palën shqiptare dhe më 7.1.2008, për palën austriake, hyrë në fuqi më 7.1.2008.
  28. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrit të Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrit Federal të Transportit, Inovacionit dhe Teknologjisë të Republikës së Austrisë për bashkëpunimin me orientim teknologjik në fushën e shëndetësisë”, nënshkruar më 5.06.2008, hyrë në fuqi me nënshkrim.
  29. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe Unicredit Bank Austria, për financimin për përmirësimin e pajisjeve mjekësore për spitalin universitar “Shefqet Ndroqi”, me një kredi të butë prej 7 488000 (shtatë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë) euro, nënshkruar më 6.05.2009.
  30. Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme Federale të Republikës së Austrisë mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë së brendshme, nënshkruar më 27.01.2010.
  31. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë mbi ndihmën e ndërsjellë në rast të katastrofave ose të fatkeqësive të mëdha”, nënshkruar më 27.01.2010, do të hyjë në fuqi më 1 korrik 2011.
  32. Marrëveshje e kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (si huamarrës) dhe UniCredit Bank Austria AG (si huadhënës), për financimin e modernizimit të 6 spitaleve rajonale

- kryesore, nënshkruar më 30 korrik 2010, hyrë në fuqi më 21.2.2011.
- 33.** Marrëveshje për bashkëpunimin financiar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, përfaqësuar nga Ministri Federal i Financave, nënshkruar më 7.12.2010, hyrë në fuqi më 1.5.2011.
- 34.** Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe Unicredit Bank Austria, për financimin e projektit “Furnizimi me uje i Bilishtit-kontarteme çelsa ne dore” nënshkruar më 19 korrik 2011.
- 35.** Protokollin ndryshues i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e Kulturës, Arsimit dhe Shkencës, nënshkruar më 29 gusht 2012 dhe miratuar me VKM-në nr. 657 datë 26.09.2012, hyrë në fuqi më 16.11.2012.
- 36.** Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë “Për bashkëpunimin në lidhje me huadhënien e objekteve që i përkasin trashëgimisë së luajtshme kulturore të shtetit për ekspozimin në territorin e shtetit tjetër”, nënshkruar më datë 29 gusht 2012 dhe miratuar me ligjin nr.97/2012, datë 18.10.2012, hyrë në fuqi më 16/11/2012.
- 37.** Marrëveshja për bashkëpunimin në fushën shkencore dhe teknike, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, nënshkruar më 2 maj 2012, dhe hyrë në fuqi më datë 1 janar 2013.
- 38.** Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale Republikës së Austrisë “Për shkëmbimin e ndërsjellë të dhënave në Çështjet e kontrollit të migracionit dhe çështjet e Azilit”, nënshkruar më datë 29 janar 2013 dhe hyrë në fuqi më 1 korrik 2013.
- 39.** “Marrëveshja e Kredisë për Eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe UniCredit Bank Austria AG, për financimin e projektit mbarëkombëtar të radioterapisë”, nënshkruar më 10.04.2013.
- 40.** Marrëveshja e Kredisë së Eksportit ndërmjet Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Erste Bank Der Oesterreichischen Sparkassen AG (Huadhënësi) për projektin e tatimit elektronik (E-Taxation)”, nënshkruar më 27.03.2013.
- 41.** Marrëveshja ndërmjet Republikës së Austrisë dhe Republikës së Shqipërisë mbi sigurimet shoqërore. Nënshkruar më 25/01/2017, hyrë në fuqi më 01/12/2018.
- 42.** Marrëveshje administrative për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Austrisë dhe Republikës së Shqipërisë për sigurimet shoqërore. Nënshkruar më 25/01/2017, hyrë në fuqi më 12/01/2018.